VENDIM
Nr. 116,datë 1.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "HIDROPOWER ELEKTRIK" SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2,germa"a"; 9 dhe 13, pika 1, germa"d",të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar,neneve 4, pika 1, germa"g"; 5, pika 2; 8, 10/3;të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hidropower Elektrik" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë "Hidropower Elektrik" sh.p.k., plotëson pjesërishtkërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskalështë i plotësuarpjesërisht. (Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave.)

Të dhënat specifike sipas tipit të licencës për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike:

- Neni 9, pika 4/10, germat"a","b" dhe "c" është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/tëpjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë"Hidropower Elektrik" sh.p.k.,për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëvetë ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti